



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Strategji dhe teknika të komunikimit

Ngarkesa: 6 ETCS, 30leksione / 30 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në "Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zhvillojë te studentët kompetenca të avancuara komunikuese, në përputhje me kërkesat dhe realitetet bashkëkohore shoqërore e profesionale. Të nxisë aftësinë për të përzgjedhur dhe përdorur strategjitë dhe teknikat e duhura të komunikimit në kontekste të ndryshme ndërpersonale dhe institucionale. Të përgatisë studentët për një pjesëmarrje aktive, reflektuese dhe të pavarur në proceset e komunikimit në mjediset akademike dhe profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë dhe të analizojë teoritë dhe konceptet kryesore që lidhen me strategjitë dhe teknikat e komunikimit.
2. Të zhvillojë aftësitë për ndërtimin, përshtatjen dhe transmetimin e mesazheve të qarta dhe efektive në situata të ndryshme komunikimi (formal/informal, publik/mediatik).
3. Të aftësohet për të përdorur mjete të ndryshme komunikuese, përfshirë materialet audiovizive dhe platformat digjitale, në funksion të forcimit të mesazhit dhe ndërveprimit.

Rezultate të pritshme:

1. Studenti është në gjendje të identifikojë dhe të analizojë strategjitë dhe teknikat e komunikimit në kontekste të ndryshme kulturore, institucionale apo sociale.
2. Studenti zbaton në mënyrë të përshtatshme njohuritë teorike në ndërtimin dhe përcjelljen e mesazheve efektive përmes mjeteve të ndryshme komunikuese.
3. Studenti demonstroi aftësi të punës në grup, ndërveprimi dhe vetëreflektimi në situata reale ose të simuluar të komunikimit, duke treguar kompetencë të qëndrueshme në këtë fushë.